

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut,nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nebojša Boričić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

E.(F) G., nga K. Podujevë

Kundër:

M. (S) S., Niš, R Srbija

Palë kërkuese në Agjencinë Kosovare të Pronave,

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/148/2012, të datës 19 Prill 2012, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA38251), pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 29 Janar 2020, merr;

AKTGJYKIM

Hedhet Poshtë si e pas afatshme, Ankesa e paraqitur nga E.(F). G., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/A/148/2012, të datës 19 Prill 2012, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP, me numër KPA38251.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike;

1. Me datë 26 Nëntor 2007, M. S. S.,(tani e tutje, “pala kërkuese”), ka paraqitur kërkesë në Agjencisë Kosovare të Pronës (tutje, AKP), në cilësinë e bartësit të pretenduar të drejtës pronësore si bashkëpronare me vëllain e saj R. M. ,secili me nga ½ pjesë ideale, me të cilën ka kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore dhe ri-posedimin e ngastrës kadastrale, nr. 890, me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.10.50 ha, me kulturë tokë e kultivuar bujqësore, e klasit të 2-të, e cila gjendet në vendin e quajtur, “...”, në fshatin ..., Komuna e Podujevës, (tani e tutje: “prona e kërkuar”).
2. Pala kërkuese pretendon se pas vdekjes së babait të saj, sipas Vendimit të trashëgimisë e ka fituar të drejtën e pronësisë, andaj kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore. Në shënimet kadastrale prona e kërkuar evidentohet ende në emër të babait të saj të ndjerë. Po ashtu deklaroi se xhaxhi i saj pronën e kërkuar e ka shfrytëzuar, ndërsa posedimin e saj e kanë humbur me 26 Qershor 1999, kur ai është larguar, si pasojë e rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur të ndodhur në Kosovë në vitet 1998/1999, ndërsa nuk ka njohuri a shfrytëzohet nga ndokush toka e kërkuar.
3. Në mbështetje të kërkesës së saj , në AKP ka paraqitur dokumentet si në vijim;
 - Certifikatën e saj të martesës , të dt. 13.02.1979, nga e cila vërtetohet se është vajza e të ndjerit S. M. M.
 - Fletën Poseduese nr..., të dt.14.01.2002, sipas së cilës babai i palës kërkuese evidentohet si pronarë me 1/1 pjesë ideale, i pronës së kërkuar

- Vendimin e Trashëgimisë VII 0-60/02, të dt. 25.02.2002, sipas së cilës pala kërkuese, bashkëshortja e tij dhe djali i të ndjerit S. M., shpallen trashëgimtarë, me nga 1/3 pjesë ideale të pronës së kërkuar dhe ngastrave tjera që nuk janë objekt i kësaj lënde.
 - Vendimin e Trashëgimisë ,VII-0-60/02, të dt.19.06.2002,(i plotfuqishëm prej 08.07.2002), sipas të cilit pala kërkuese dhe vëllai i saj R. M. janë shpallë trashëgimtarë të pronës së kërkuar me nga ½ pesë ideale, pasi që ka hjekur dorë nga trashëgimia nëna e tyre S. M.
4. Me datë 16 maj 2008, AKP-ja, bëri njoftimin e kërkesës duke vendosur lajmërimin në pronën e kërkuar, e cila është gjetë jetë tokë e pa kultivuar-livadh, jo e uzurpuar, notifikimi fillestar kishte rezultuar i pa saktë. Gjatë notifikimit të dytë me datë 17.12. 2009, prona e kërkuar është gjetur tokë e kultivuar, e uzurpuar nga personi i pa njohur.
 5. Më datë 23.08.2010, E.G., paraqitet në AKP, i njëjti kishte pretenduar të drejtë ligjore në pronën e kërkuar (tutje: “pala ankuese”), dhe e kishte nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes në procedurë. Ai deklaroi se e kundërshtoi në tërësi kërkesën e ushtruar nga pala kërkuese M. S., lidhur me pronën e kërkuar, sepse të njëjtën e ka blerë qysh në vitin 1984 dhe nga atëherë e shfrytëzon, propozon që lidhur me këtë transaksion të dëgjohen dëshmitarët që ishin prezent me rastin e shitblerjes së patundshmerisë. I njëjti nuk arrin të ofroj dëshmi me shkrim apo kontratë shitblerje për këtë pronë por deklaroi se dokumentet i janë djegur gjatë luftës së fundit.
 6. Në mbështetje të pretendimeve të tij, së bashku me përgjigjen, ka paraqitur;
 - Kundërshtimin me shkrim sipas të cilit thekson se pronën e kërkuar e blerë në vitin 1984 nga atëherë e shfrytëzon dhe se çmimin e shitblerjes ja kanë paguar në tërësi pronarit, po ashtu i propozon dëshmitarët që ishin prezent, A. ,R. ,Q., dhe R., të gjithë me mbiemër G. nga f. ..., dhe
 - Disa foto të një objekti të djegur të banimit.
 7. Nga deklaratat e dhëna nga pala ankuese në AKP, sekretaria e këtij organi vlerëson se, deklaratat e tij janë kontradiktore lidhur me pretendimet në pronën e kërkuar duke mos qenë i saktë rreth kohës kur e ka blerë pronën, atij nuk i kujtohet viti saktë i shitblerjes, gjithashtu kishte ofruar foto të një shtëpie të djegur i cili më vonë kishte sqaruar se kjo shtëpi është e tij e ndërtuar në një pronë tjetër e jo në pronën e kërkuar, gjer sa me këto foto ka dashtë të dëshmojë se i ishte djegur e njëjta.
 8. Megjithatë Sekretarie e AKP-së, nuk kishte arrit as *ex officio* të sigurojë informacione shitesë të rëndësishme, lidhur me pretendimet e palës ankuese se e ka blerë pronën lëndore, po ashtu kontrata të cilën e cek të shitblerjes pala ankuese, nuk është arrit të gjendet në arhivat e gjykatës apo organe të tjera kompetente.

9. I kontaktuar nga sekretaria e AKP-së, pala kërkuese kishte mohuar se pronën e cila është e regjistruar në emër të babait të saj sipas fletës poseduese se i është shitur palës ankuese.
10. Sipas raportit të verifikimit të sekretarisë së AKP-së, të datës 08.02.2012, zyrtari për verifikim i kishte verifikuar pozitivisht dokumentet pronësore të dorëzuara nga pala kërkuese në APK dhe ate Vendimet mbi trashëgimin dhe Fletën poseduese, nga e cila vërtetohet se prona e kërkuar , ngastra kad. nr. ..., dhe disa të tjera, evidentohet në emër të babait të palës kërkuese të ndjerit S. M. (M).
11. Me 19 prill 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (tani e tutje: KKPK), me Vendimin e tij grupor KPCC/D/A/148/2012, vendosi se pala kërkuese e ka dëshmuar të drejtën e saj se është pronare me ½ pjesë ideale e ngastrës kad. nr. ..., në sipërfaqe prej 0.10.50ha., andaj ka të drejtën e posedimit të saj. Në arsyetimin e vendimit të ankimuar, (paragrafët 45-47), theksohet se pala kërkuese në bazë të vendimit mbi trashëgimin e ka dëshmuar se ajo dhe vëllai i saj e kanë trashëguar pronën e kërkuar nga babai i tyre. Pala përgjegjëse(është fjala për palën ankuese), theksohet se nuk arriti të dëshmoj me dëshmi valide se e ka blerë pronën kontestuese, në deklaratat e tij ai deklarativisht e theksonte blerjen në data të ndryshme, gjer sa pala tjetër e mohonte shitjen e pronës së saj, andaj komisioni vlerëson se pala ankuese ka dështuar të bëjë kundërshtim të vlefshëm ,ndaj paraqitësit të kërkesë për pronën lëndore.
12. Me datë 17 Tetor 2012, nga shërbimi i ekspeditimit të AKP-së, Vendimi i KKPK-së, i është dorëzuar palës ankuese E. F. G. por i njëjti nuk kishte dashtë të nënshkruaj fletë dorëzimit e pranimit dorëzimit. Megjithatë, pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër tij, me datë 23 maj 2016, data në ankesë,(ndërsa e protokolluar me vulë të pranimit në AKP, me datë 24 maj 2016).
13. Më datë 14 Nëntor 2012, Vendimi i KKPK-së, i është dorëzuar palës kërkuese në AKP- Milijana Stanković. Në shkresa të lëndës nuk ka prova që ndaj tij ka ushtruar ankesë.

Pretendimet e palës ankuese;

14. Pala ankuese vendimin e KKPK-së, e kundërshton në tërësi nga të gjitha bazat ankimore. Në pjesën e II-të të ankesës,(sipas formës), thekson se, pronën e ka blerë në vitet e tetëdhjeta, kontratën interne e ka pas e cila u djegë gjatë luftës. Ankesës i bashkëngjit kundërshtimin me shkrim ku ndër të tjera thekson se; pronën e kërkuar e ka blerë në vitin 1984 dhe nga atëherë është në posedim dhe shfrytëzim të saj ,se në atë kohë ishte e ndaluar vërtetimi i kontratave në mes shqiptarëve dhe serbeve, andaj propozon të dëgjohen katër dëshmitarë që ishin prezent kur është blerë prona të cilët i cek me emër e mbiemër. Ankesës i bashkëngjit fotokopjet e L.Nj. të tij, dhe katër dëshmitarëve të propozuar nga ia.

Arsyetimi ligjor ;

15. Ankesa është e pas afatshme. Neni 12.1,i Ligjit nr. 03/L-079, “Mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë

komerciale” (në tekstin e mëtejme “Ligji nr. 03/L-079”), përcakton si në vijim: “*Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqes ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës*”.

16. Pala ankuese e ka pranuar Vendimin e KKKP-së, me 17 Tetor 2012, kurse ankesën e ka paraqitur me datë 23 Maj 2016,(e protokolluar me vulë pranimi në AKP, me datë 24 maj 2016). Kjo do të thotë se ankesa është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar me ligj 30 ditë nga dita e pranimin të Vendimit të KKKP-së. Afati për ankesë ka qen gjer me datë 16 Nëntor 2012.
17. Gjykata ka gjetur se dorëzimi është bërë në përputhje me nenin 110.1, të Ligjit nr. 03/L-006, për Procedurën Kontestimore, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38/2008), duke ju dorëzuar personalisht Vendimi i KKKP-së, dhe në kuptim të nenit 121.3, edhe pse pala ankuese ka refuzuar për të nënshkruar fletë dorëzimin, por me që është shkruar dita e saktë kur i është dorëzuar vendimi i ankimuar pra me datë 17 tetor 2012, sipas kësaj dispozite ligjore, konsiderohet se dorëzimi është kryer në mënyrë të rregullt dhe ligjore.
18. Pala ankuese në ankesën e paraqitur nuk ka cekur asnjë fakt dhe nuk ka paraqitur asnjë arsye për vonesën në paraqitjen e ankesës, ndërsa as gjykata në shkresat e lëndës nuk ka gjetur asnjë arsye të arsyeshme për vonesën u ushtrimit të kësaj ankese.
19. Prandaj, ankesa hedhet poshtë si e papranueshme në bazë të arsyeve procedurale të ligjit të lartpërmendur. Rrjedhimisht Gjykata Supreme nuk ka mundur t’i shqyrtoj arsyet e ankesës.
20. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në përputhje me nenin 13.3.(b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195, paragrafin 1(a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore;

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSK-KPA-A-070-2016, me datë 29 janar 2020

Bashkp. Profesional
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani